

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

9.01.2023
Ora, 11:32

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Agron Faslli Kapllanaj, kandidat për deputet i propozuar nga Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Fier, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **KRIK, Përfaqësues nga Shoqëria Civile**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve, në rend dite për sot kemi këto çështje për shqyrtim:

Projektvendimin që ka të bëjë me “Shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zoti Agron Faslli Kapllanaj, kandidat për deputet i propozuar nga Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” (PD-AN), Qarku Fier”.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

Projektvendimin që ka të bëjë me “Shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zoti Kleo Hekuran Murataj, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Social Demokrate e Shqipërisë, Qarku Tiranë”.

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve, “Për përcaktimin e minimumit jetik””.

Projektvendim “Për përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Projektvendim “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ-së, KQV-së, Kryetarit të KQV-së dhe vulës rezervë për KQV-në për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Projektvendim “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”.

Pika e shtatë “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Përmet” dhe

Pika e tetë “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me “Shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të organit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zoti Agron Faslli Kapllanaj, kandidat për deputet i propozuar nga Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” në Qarkun e Fierit”. Po Sekretari i Përgjithshëm!

Z. Y. Merkaç: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

subjekte ndër të cilat është edhe “Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë”. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Agron Faslli Kapllanaj, kandidat për deputet i Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Fier, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. 2123 unik. Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, KQZ bëri verifikimin paraprak dhe ka konstatuar se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit.

Në këto rrethana ka marrë vendimin nr.156 datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ku ka vendosur “Miratimin e listave shumëmemërore të koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Fier për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka bërë verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet zotit Agron Faslli Kapllanaj. Nga verifikimi i të dhënave rezulton se në rubrikën III, “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pyetjes 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se: Është dënuar për ngjarjen e ndodhur më datë 26.07.1995, sipas nenit 624 K.P.

Pyetjes 3, “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se: Është hetuar/gjykuar nga Gjykata e Firencës, në Itali, për veprën penale të parashikuar sipas nenit 624 të Kodit Penal Italian.

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: Ka jetuar në Katana, Itali, si rezident, për periudhën 1999-2000. Nga konstatimet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t'ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra. Me shkresën nr. 516/54 prot., datë 21.12.2022, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin "Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin vetëdeklarues zotin Agron Faslli Kapllanaj, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, është konstatuar si me poshtë:

- Nuk rezultoi të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të padeklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
- Rezulton i dënuar me vendim të Gjykatës së Firencës që ka marrë formë të prerë në datën 17.02.2004 për veprën penale "Vjedhje", e parashikuar nga neni 624, i Kodit Penal Italian me 2 vjet heqje lirie dhe 200 euro gjobë dhe në bazë të nenit 163 të Kodit Penal Italian është pezulluar dënimi me kusht;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton që ka qënë në hetim në funksion të procedimit penal viti 2012, i cili është pushuar në datën 12.10.2012;
- Nuk rezulton të ketë qënë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerje të një vepre penale;
- Nuk rezulton që ndaj tij të jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
- Nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i ndonjë shteti të huaj.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*


Referuar Gjykatës së Firences i cili është dënuar me dy vite burg dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datë, 17.02.2004, si dhe referuar nenit 4, pika 3 të ligjit 138/2015, periudha e ndalimit është 10 vite nga momenti i përfundimit të dënimit, për këtë arsye periudha dhjetë vjecare e ndalimit fillon saktësisht nga data 18.02.2006 dhe përfundon më datë 18.02.2016. Me përfundimin e periudhës së ndalimit për të kandiduar apo për ushtrimin e funksionit, në kuptim të ligjit nr.138/2015 subjekti konsiderohet i rehabilituar. Për sa më sipër subjekti deklarues, zoti Agron Faslli Kapllanaj, kandidat për deputet i subjektit politik, Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim Qarku Fier, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit, apo moszgjedhshmërisë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Atëhere, bazuar në nenin 19, pika1, shkronja “n”, pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 90, 95 të Ligjit 44/2015 Kodi i Procedurës Administrative, Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”, pika 12 dhe 13 të Kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, vendos:

- Konstatimin se zoti Agron Faslli Kapllanaj, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, Qarku Fier, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të deputetit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda tre ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Vendimi nr. 3

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

9.01.2023
Ora, 11:40

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kleo Hekuran Murataj, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **KRIK, Përfaqësues nga Shoqëria
Civile**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me rezultatet e verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për kandidatin tjetër.

Z. Y. Merkaj: Kandidati për deputet për zgjedhjet e 25 prillit 2021 zoti Kleo Hekuran Murataj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 1783. Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Partia Socialdemokrate, KQZ bëri verifikimin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

paraprak ku konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. ndërmori hapat e mëposhtme:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar me vendimin nr. 157 datë 17.03.2021, listën shumemërore të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, për Qarkun Tiranë për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit për subjektin vetëdeklarues, ku konstatoi se në rubrikën “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, pyetjes 1, A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet shqiptar ose i huaj? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 1991, me vendim nr. 129. Gjithashtu pyetjes, “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose në gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Ka qenë i shoqëruar në vitin 2016 nga policia e Hannoverit në Gjermani. Gjithashtu pyetjes 4, “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e ndonjë vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Në vitin 1991 është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu ka qenë i shoqëruar në vitin 2016 nga Policia e Hannoverit.

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Në vitin 1992 - 1995, ka jetuar në Athinë Greqi, si emigrant ekonomik.

Ndërsa në shkurt 2016 deri në prill 2016, ka jetuar në Gjermani, për arsye biznesi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*


Nga konstatimet e mësipërme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t'ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Kleo Hekuran Murataj”. Në përfundim të hetimit konstatohet se:

- Nuk rezultoi të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- Rezulton që ka qenë në hetim në funksion të procedimit penal në vitin 1991, është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim të formës së prerë, me dy muaj riedukim nëpërmjet punës duke ju ndaluar 1/6 e pagës.
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar, apo i huaj.
- Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerje të një vepre penale.
- Nuk rezulton që ndaj tij të jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale.
- Nuk rezulton të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij.
- Nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i ndonjë shteti të huaj.

Nga verifikimet e mësipërme rezulton se, kandidait për deputet i subjektit politik, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, Qarku Tiranë, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit, ose të moszgjedhshmërisë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Atëhere, bazuar në nenin 19, pika1, shkronja “n”, pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 90, 95 të Ligjit 44/2015 Kodi i Procedurës Administrative, Ligjit nr. 138/2015 “Për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”, pika 12 dhe 13 të Kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, vendos:

- Konstatimin se zoti Kleo Hekuran Murataj, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor i Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, Qarku Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të deputetit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda tre ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Vendimi nr. 4

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

9.01.2023
Ora, 11:45

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve, për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për përcaktimin e minimumit jetik”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **KRIK, Përfaqësues nga Shoqëria
Civile**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika e tretë që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues për nismën ligjvënëse të zgjedhësve, “Për përcaktimin e minimumit jetik”.

Z. Y. Merkaj: Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse të zgjedhësve, i përbërë nga tetë zgjedhës kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 3197 prot, datë 16.09.2022, për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për përcaktimin e minimumit jetik”. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 198, datë 29.09.2022, vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

nënshkrimeve për nismën ligjvënëse. Gjithashtu pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa me datë 9.12.2022, me lëndë “Depozitimi i nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve, për propozimin e projektligjit “Për përcaktimin e minimumit jetik”. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar edhe Memorandumi i Bashkëpunimit midis Komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse dhe grupit të mbledhjes së nënshkrimeve. Referuar nenit 14, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka verifikuar nënshkrimet si dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës. Referuar udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nenit 7, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e pesë për qind të numrit të nënshkrimeve si dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, brenda afatit ligjor të parashikuar. Në total janë depozituar 932 fletë, me 21 300 nënshkrime, të ndara në 6 dosje. Në referim të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, kërkohet që nisma ligjvënëse të nënshkruhet nga jo më pak se 20 000 zgjedhës. Ka rezultuar se numri i zgjedhësve të cilët kanë mbështetur nismën e plotëson numrin prej 20 000 zgjedhësish të kërkuar nga ligji. Përsa më sipër, konstatohet se nënshkrimet e depozituara nga përfaqësuesit e nismës ligjvënëse për të propozuar projektligjin “Për përcaktimin e minimumit jetik”, janë dorëzuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe si të tilla duhet të pranohen. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e nismës janë prezent, dëshironi të thoni diçka? Ju lutem para dhe me mikrofon nëse keni diçka! Nuk keni! Në rregull! Bazuar në çfarë u relatua në lidhje me këtë porojektakt si dhe në nenet 19, pika 2 dhe 71 të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, nenin 14, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidateve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, vendos:

- Regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për përcaktimin e minimumit jetik”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Vendimi nr. 5

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

9.01.2023
Ora, 11:49

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **KRIK, Përfaqësues nga Shoqëria
Civile**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Kodi Zgjedhor neni 29, pika 1 shkronja “a” dhe “b” përcakton se anëtarët e KZAZ-ve emërohen nga KQZ-ja sipas procedurës së mëposhtme:

Dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare;


Dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare;

Një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare;

Një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare.

Në rast se nuk arrihet barazpeshimi politik grupi përkatës kompenson me kandidaturat e partisë kryesore deri në barazpeshimin politik shumicë-opozitë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare. Sekretari i KZAZ-së propozohet nga partia politike që propozon zv.kryetarin e KZAZ-së. Nga ana tjetër legjislatori ka përcaktuar një dispozitë kalimtare nenin 18, pika 3 e Kodit Zgjedhor e cila është e aplikueshme për zgjedhjet e paratë përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të vitit 2020. Bazuar në këtë dispozitë e cila gjeti zbatim në zgjedhjet e para të përgjithshme të datës 25 prill 2021, përcaktoi qartë se rezultati në zgjedhjet e datës 25 qershor 2017 për Kuvendin e Shqipërisë do të caktojnë partitë që do të kenë të drejtën të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e Komisioneve të Administrimit Zgjedhor dhe në zgjedhjet e para vendore të vitit 2023. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zgjedhjet e vitit 2021, bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të datë 25 qershor 2017, si dhe pas komunikimit zyrtar me Kuvendin e Shqipërisë dhe konsultimit publik me partitë politike, me vendimin nr. 40, datë 23.12.2020 ka përcaktuar partitë politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvendin e Datës 25 Prill 2021 dhe ka vendosur që:

- Partia Socialiste e Shqipërisë, si parti kryesore e shumicës parlamentare do të propozojë dy anëtarë në çdo KZAZ.
- Partia Socialdemokrate, parti e dytë e shumicës parlamentare do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ.
- Partia Demokratike, parti kryesore e opozitës parlamentare do të propozojë dy anëtarë në çdo KZAZ.
- Lëvizja Socialiste për Integrim e ndryshuar me emrin Partia e Lirisë, partia e dytë e opozitës parlamentare do të propozojë një anëtar në çdo KZAZ.

Për sa më sipër edhe në zgjedhjet e para vendore të datës 14 maj 2023, do të ndiqet e njejta praktikë si në zgjedhjet e para të përgjithshme të vitit 2021 sikurse legjislatori

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*


kërkon. Referuar parashikimeve të nenit 29, paragrafi 1, germa “b”, anëtari i shtatë në gjysmën e KZAZ-ve do të propozohet nga Partia Socialiste si parti e parë e shumicës parlamentare, ndërsa në gjysmën tjetër të KZAZ-ve do të propozohet nga Partia Demokratike si parti e parë e opozitës parlamentare. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike? S’kemi! Dakord! Mirë atëhere, bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

Përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), që do të ngrihen dhe funksionojnë për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, si më poshtë:

- Dy anëtarë në çdo KZAZ propozohen nga Partia Socialiste e Shqipërisë.
- Një anëtar në çdo KZAZ propozohet nga Partia Social Demokratike.
- Dy anëtarë në çdo KZAZ propozohen nga Partia Demokratike.
- Një anëtar në çdo KZAZ propozohet nga Partia e Lirisë.
- Anëtari i shtatë i KZAZ-ve do të propozohet në përputhje me rezultatet e shortit të hedhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërmjet Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë Demokratike.
- Sekretari i KZAZ-së do të propozohet:
- Nga Partia Socialiste e Shqipërisë në KZAZ-të, ku Partia Socialiste ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së.
- Nga Partia Demokratike në KZAZ-të, ku Partia Demokratike ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së.
- Partitë politike duhet të paraqesin kandidaturat për anëtarë të KZAZ-ve jo më vonë se data 29.01.2023, pra, 29 janar 2023.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda tre ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Vendimi nr. 6

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

9.01.2023
Ora, 11:53

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ-së, KQV-së, Kryetarit të KQV-së dhe vulës rezervë për KQV-në për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **KRIK, Përfaqësues nga Shoqëria
Civile**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës me miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ-së, KQV-së, Kryetarit të KQV-së dhe vulës rezervë për QV-në.

Z. Y. Merkaj: Referuar përcaktimeve të nenit 99, të Kodit Zgjedhor, KQZ dërgon në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, materialet zgjedhore që përdoren nga KZAZ për administrimin e procesit zgjedhor, dhe materialet zgjedhore për Komisionet e Qendrave të Votimit, për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit. Në materialet zgjedhore të përcaktuara në këtë dispozitë, përfshihen vula e KZAZ-së, vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së, vula rezervë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

për KQV-të. Kodi Zgjedhor, në nenin 103, pika 2, përcakton tekstin që duhet të përmbajë:

vula e KQV-së: “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit;

vula e kryetarit të KQV-së: “KRYETARI” dhe një numër serial pesëshifror;

vula rezervë: teksti është unik për secilën vulë, përcaktuar me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”. Formatit dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së, vulës së KQV-së, vulës së Kryetarit të KQV-së, dhe vulat rezervë për Komisionet e Qendrave të Votimit, referojnë përcaktimet e VKM nr. 390, datë 6.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit, dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, të ndryshuar. Ato prodhohen në sektorin e prodhimit të vulave zyrtare, pranë Ministrisë së Brendshme, me kosto njëmijë e tetëqind lekë.

Bashkëlidhur projektvendimit paraqiten:


- lidhja 1, formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së;
- lidhja 2, formati dhe specifikimet e vulës së KQV-së;
- lidhja 3, formati dhe specifikimet e vulës së Kryetarit të KQV-së;
- lidhja 4, formati dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Dakord besoj?! Atëhere, miratojmë projektaktin sipas draftit të paraqitur dhe lidhjeve respektive për vulën e KZAZ-së, vulën e KQV-së, vulën e Kryetarit të KQV-së dhe vulën rezervë për KQV-në.

Vendimi nr. 7

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

9.01.2023
Ora, 11:57

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **KRIK, Përfaqësues nga Shoqëria
Civile**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”.

Z. Y. Merkaj: Neni 15 dhe pika 2 e ligjit “Për partitë politike” ka parashikuar kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të hartuar dhe miratuar rregullat për raportimin financiar të partive politike si dhe formatet e standartizuara

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

për raportimin vjetor. Neni 23 i këtij ligji parashikon afatin e dorëzimit të raporteve financiare vjetore, personat përgjegjës për dorëzimin e këtyre raporteve si dhe afatin e publikimit të raporteve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për sa më sipër është hartuar projektvendimi për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formateve të standartizuara për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrolli, verifikimi, financimi, shpenzimi i tyre si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë. Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standartizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, si dhe mënyrën e raportimit sipas formatit të përcaktuar. Për sa më sipër i paraqesim Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtim dhe miratim projektvendimin e mësipërm, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, do ta shtyjmë miratimin e këtij projektakti pasi kemi marrë një e-mail nga Organizata KRIIK në lidhje me përmbajtjen e këtij projektakti. Do të vlerësojmë opinionin dhe mendimet e KRIIK-ut në lidhje me këtë projektakt. Shqyrtimin dhe miratimin eventualisht të tij do ta lemë në seancën e radhës. Përfaqësuesi i Partisë Demokratike? S'keni ndonjë gjë! Dakord!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

9.01.2023
Ora, 11:57

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Malvina Hasan Fida”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **KRIK, Përfaqësues nga Shoqëria
Civile**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër!

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Dibër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari zoti Besmir Fatmir Markeçi, propozuar nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidatja me numër rendor 18, zonja Malvina Hasan Fida, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 54. Nga verifikimi i formularit të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*


vetëdeklarimit, konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime të Ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se kandidatja është e padënuar me vendim penal të formës së prerë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka sjellë informacion ku konstatohet se ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Konstatohet se me lidhjen e martesës ka marrë mbiemrin nga Cara në Fida. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zonjës Malvina Hasan Fida në Këshillin e Bashkisë Dibër nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive? S'kemi diskutim! Mirë atëhere, vendoset:

- Plotësimi i vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Malvina Hasan Fida.

Vendimi nr. 9

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

9.01.2023
Ora, 12:01

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Përmet, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, zonjën Gjyrgji Kame Mançellari”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **KRIK, Përfaqësues nga Shoqëria
Civile**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Përmet!

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Përmet, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari zoti Gerald Manol Ilia, propozuar nga subjekti politik, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane për Këshillin e Bashkisë Përmet, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidatja me numër rendor 2, zonja Gjyrgji Kame Mançellari, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

formularin e vetëdeklarimit me numër unik 55. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime të Ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku konstatohet se kandidatia është e padënuar me vendim penal të formës së prerë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka sjellë informacion ku konstatohet se ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Me lidhjen e martesës ka marrë mbiemrin nga Alikollari në Mançellari. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zonjës Gjyrgji Kame Mançellari në Këshillin e Bashkisë Përmet nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit të bashkisë, ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëhere, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Përmet, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, zonjën Gjyrgji Kame Mançellari.

Kemi tjetër çështje në rendin e ditës? Nuk kemi! Faleminderit, seanca mbyllet!

Vendimi nr. 8

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

